




PROGEEN
CONSTRUCTION

PROGEEN shpk
PROFILI I KOMPANISE

PROGEEN SHPK RRETH NESH

Progeen është një shoqëri e re në fushën e ndërtimit. Stafi i kompanisë përbëhet nga profesionistë me përvojë të gjatë e të shkëlqyer në fushën e ndërtimit në vend. Vlerat kryesore të Progeen janë profesionalizmi dhe marrëdhënia solide e besueshmërisë me bashkëpunëtorët dhe klientët e saj, duke i përfshirë në çdo hap të suksesit e arritjeve të saj.

Progeen operon në fushën e ndërtimit në vend edhe si kontraktor edhe si investitor në ndërtimin e godinave civile të banimit i përqendruar në Tiranë. Në 4 vjet Progeen ka zgjeruar portofolin e investimeve të saj në mënyrë shumë cilësore dhe në të njëjtën kohë ka përfunduar me sukses kontrata të rëndësishme për palë të treta.



CILËSIA E LARTË E NDËRTIMIT ËSHTË FAKTORI KYÇ I SUKSESIT TË SHOQËRISË DHE ELEMENTI DALLUES NË ÇDO PROJEKT.

#1 — 20 VJET PËRVOJË

Përvoja jonë fillon përpara Progeen nëpër projektet më madhore të ndërtimit civil e industrial në Shqipëri. Stafi teknik i kompanisë mbart mbi vete vlera e ekspertiza të fituara nga kompanitë më të mëdha e më serioze të ndërtimit në vend.

#2 — FLEKSIBILITET

Skuadra jonë e projektimit brenda kompanisë mundëson efikasitet të lartë në projektimin arkitekturor dhe inxhinierik si edhe në ndjekjen nga afër të të gjitha fazave të zbatimit me të gjitha dinamikat e tyre.

#3 — ZGJIDHJET MË TË MIRA INXHINIERIKE

Përvoja e gjatë e stafit tonë teknik na mundëson të ofrojmë zgjidhjet më të mira inxhinierike për kërkesat e klientëve. Gjatë këtyre viteve kemi mesuar metodat më të mira, ato që duhen dhe nuk duhen bërë për shumicën e rrathanave të ndërtimit në Shqipëri.

#4 — EFIKASITET I LARTË

Është gjithnjë dikush më i lirë, megjithatë e lira nuk përbën gjithnjë vlerë. Ne i vlerësojmë me kujdes zgjidhjet që në faza e hershme të projektimit për të arritur efikasitet maksimalë sipas prioritetëve të klientit.



Çfarë bëjmë SHËRBIMET TONA

Complete solutions

ME ÇELËSA NË DORE

Zgjidhje e plotë

Progeen i mbulon të gjitha proceset e lidhura me ndërtimin brenda kompanisë duke i ofruar klientit shërbime me çelësa në dorë. Këto shërbime ofrohen kryesisht nëpërmjet kontratave FIDIC. Zgjidhjet tona me çelësa në dorë përfshijnë shërbimet e mëposhtme.



PROJEKTIM:

Zgjidhje Strukturore & Arkitektonike

Shërbimet tona të projektimit përfshijnë:

- Projekti arkitektonik
- Projekti elektrik
- Projekti strukturor
- Projekti mekanik
- Projekti hidroteknik
- Projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit

NDËRTIM

Civil & Industrial

Progeen është plotësisht e aftë dhe ka përvojën e duhur për të marrë përsipër një gamë të gjërë punësh ndërtimi si civile ashtu edhe industriale të kryera me beton të përforcuar apo me struktura metalike. Punët përfshijnë vepra infrastrukturore si ujësjellsa, linja të tensionit të lartë apo të mesëm etj.

MENAXHIM DOKUMENTACIONI:

Aplikim & Procedura Paraprake

Kompania merr përsipër punën parapërgatitore për aplikimin për lejet e nevojshme të lidhura me ndërtimin si leja mjedisore, studimi gjeologjik, rilevimi etj. Pas aplikimit për lejet përkatëse, kompania do të monitorojë të gjithë proceset ligjore deri në përfundim të projektit.



PROJEKTET E FUNDIT TË KOMPANISË

Disa nga projektet e fundit të ndërtimit të kompanisë

Në këto pak vite që nga krijimi i saj Progeen shpk ka zhvilluar projekte të ndryshme me çelësa në dorë edhe në rolin e ndërtuesit, edhe në atë të investitorit.



ALEAT CENTRAL SITE

Ndërtimi i zyrave të reja dhe rikonstruksioni i objektit ekzistues

Ndërtimi i zyrave të reja dhe rikonstruksioni i ndërtesave egzistuese në pjesën lindore të Tiranës të cilat funksionojnë si zyra dhe ambiente për prodhimin e pasaportave dhe ID-ve biometrike. Punët për ndërtim dhe rindërtim janë kryer me standartet më të larta të nevojshme për marrjen e certifikatave të ndryshme të cilësisë.



ASHRAF 3 - GODINA SHERBIMI

11 godina për komunitetin Iranian në Shqipëri - Manëz

Progeen ndërtoi 11 godina për anetarët e Opozitës Iraniane në Mërgim të cilët jetojnë në Shqipëri. Ndërtesat ofrojnë një hapësirë të rehatshme për jetesë dhe punë. Këto ndërtesa janë pjesë e projektit Ashraf 3. Një qytet i vogël Iranian në Shqipëri i cili do të ketë të gjithë facilitetet e nevojshme për një jetesë të rehatshme.

REZIDENCA "IRIS"

Godinë Rezidenciale në Rrugën zonën e "Oxhakut"

Rezidenca Iris është godina e parë, pjesë përbërëse e një blloku banimi modern me godina 7 dhe 8 katëshe ku funksioni kryesor është banimi por duke lënë edhe hapësira të nevojshme për shërbime, zyra dyqane dhe një kat hotelerie. Gjithashtu në funksion të shërbimeve të mësipërme janë edhe 2 kate parkimi nëntokësor.



REZIDENCA PROGEEN 2

Godinë rezidenciale dhe komerciale në rrugën "Bardhyl"

Rezidenca është një godinë gjashtë katëshe në Unazën e Tiranës në Rrugën Bardhyl me vetëm katër kate banimi e përsosur për banim apo për zyra. Zgjidhja arkitekturore e fasadës së saj të ventiluar të ndërthurrur me pllaka terracota, e bëjnë të spikasë në zonën ku gjendet.



REZIDENCA RAINBOW

Godinë Rezidenciale në lagjen Don Bosko

E vendosur në zonën rezidenciale të Don Boskos në rrugën Albanopol, ajo është konceptuar të ofrojë një shtëpi komode dhe jetë të pasur komunitare me mbi 75% hapësirë të përbashkët të gjelbër. Rezidenca Rainbow është konceptuar me standartet më të larta të ndërtimit në vend.



PROJEKTET E FUNDIT TË KOMPANISË

Disa nga projektet e fundit të ndërtimit të kompanisë



ADISA - KRUIJE

Zyra për agjencinë shtetërore

Puna konsistoi në rikonstruksimin e një ndërtese të vjetër shtetërore duke e kthyer në një ndërtesë për shërbime ndaj qytetarëve. Operacionet e ndërtimit u zhvilluan në Kujë



RAPUN HEC - ELBASAN

Ndërtim dhe instalime pajisjesh

Veprimtaritë ndërtuese në HEC të Rapunit përfshijnë instalim të turbinave, frencis dhe spirale horizontale për HEC. Gjithashtu u ndërtua edhe një zyrë e vogël operative me konstruksione metalike.

MAGAZINE INDUSTRIALE

Magazinë Multi-Funkionale

Projektimi, prodhimi dhe ndertimi i magazinës multifunkionale në zonën industriale në pjesën perëndimore të Tiranës.



REZIDENCA PROGEEN 1

Ndërtesë rezidenciale në zonën e Oxhakut

Kjo godinë përfaqëson projektin e parë të kompanisë si investitor. Ajo u ndërtua me standarte ndërtimi shumë të larta arriti synimi ishte krijimi i hapësirave të rehatshme dhe ambient miqësor për komunitetin.



GARANCIA E CILESISE CERTIFIKIMET

CERTIFIKIME TE KOMPANISE

Puna jonë është në një linjë me standartet më të larta ndërkombëtare në fuqi. Kompania ka marrë certifikimet e nevojshme të cilat i aplikohen si standarteve të ndërtimit, dhe atyre të menaxhimit.





PAS 99:2012



UNI EN ISO 3834-2:2006



ISO 14001:2015



OHSAS 18001:2007



ISO 39001:2012



SA 8000:2014



PROGEEN SH.P.K.

Rr. Shyqyri Berxolli,
Pallati "Intercosat",
ap.36B, Tirane

Tel:

+355 6880 42004
+355 6920 69121

Email

info@progeen.com

Website

www.progeen.com